

GARA NDËRKOMBËTARE NGA MATEMATIKA

KENGUR

21 MARS 2006


PËR KLASËN E 3 DHE 4 TË SHKOLLAVE FILLORE

Testi punohet me kohëzgjatje prej 1 orë e 15 minuta

Për përgjigje jo të saktë të pyetjes ju hiqen një e katërta e pikëve me të cilët pyetja vlerësohet. Që të shmangët rezultati final negativ në fund shtohen 24 pikë, ashtu që numri i mundshëm i pikëve të fituara është 120. Nuk lejohet përdorimi i kalkulatorëve.

Secila prej detyrave me numër rendorë prej 1 deri 8 vlerësohet me nga 3 pikë

1. Besa vizaton tre figura të ndryshme në të njëjtën renditje. Cila figurë duhet të qëndrojë në vendin e pikëpyetjes ?




2. Vlera e shprehjes $2 \cdot 0 \cdot 0 \cdot 6 + 2006$ është:

A) 0 B) 2006 C) 2014 D) 2018 E) 4012

3. Sa kube janë hequr nga blloku djathtas ?

A) 4 B) 5 C) 6 D) 7 E) 8



4. Bore e kishte ditëlindjen dje. Nesër është e enjte. Në cilën ditë ishte ditëlindja e Borës?


A) e martë B) e mërkurë C) e enjte D) e shtunë E) e hënë

5. Blerimi ka luajtur pikado. Ai ka pasur 10 shigjeta . Për çdo goditje në qendër ka fituar edhe dy shigjeta tepër. Blerimi ka gjuajtur 20 herë. Të përcaktohet sa herë ka goditur në qendër ?

A) 6 B) 8 C) 10 D) 5 E) 4

6. Një kengur hyn në një ndërtesë. Kalimin e bën vetëm nëpërmjet të hapsirave të trekëndëshave, nga cila dalje do ta lëshojë ndërtesën?

A) a B) b C) c
D) ç E) d



7. Katër nxënës munden të ulen në një tavolinë katrore secili në njërin anë të tavolinës. Për një manifestim shkollorë nxënësit kanë bashkangjitur 7 tavolina të tilla që të fitojnë një tavolinë më të madhe. Sa nxënës mund të ulen në atë tavolinë ?

A) 14 B) 16 C) 21 D) 24 E) 28

8. Artani në kuletë ka monedha prej 5 euro, prej 1 euro dhe prej 2 euro. Cilën prej shumave të dhëna nuk mund ta paguaj Artani pa mos ti këthyer kusur ?



A) 3 euro B) 4 euro C) 6 euro D) 7 euro E) 8 euro

Secila prej detyrave me numër rendorë prej 9 deri 16 vlerësohet me 4 pikë

9. Në anën e majtë të një rruges shtëpitë janë të numëruara me numrat 1, 3, 5, ..., 19. Në anën e djathtë të rrugës shtëpitë janë të numëruara me numrat 2, 4, 6, ..., 14. Sa shtëpi ka rruga ?


A) 8 B) 16 C) 17 D) 18 E) 33

10. Nga teli prej vizatimit djathtas mund të ndërtohet drejtkëndësh. Cili nga drejtkëndëshat e mëposhtëm mundë të fitohet prej telit?



11. Numrat në vizatim janë çmimet e dhëna të rampave prej dy qyteteve fqinje. Petriti dëshiron sa më lirë të arrijë prej A deri te B. Cili është çmimi më i ulët që duhet ta paguaj Petriti ?

A) 80 B) 90 C) 100
D) 110 E) 180




12. Gjashtë numra janë shënuar në kartuçe si në vizatim. Cili është numri më i vogël që mund të formohet me ndërlidhjen e këtyre kartuçeve ?

A) 1234567890 B) 1023456789
C) 3097568241 D) 2309415687 E) 2309415678


13. Gjashtë tase prej (1g, 2g, 3g, 4g, 5g и 6g) janë vënduar në tre pako – nga dy në çdo pako. Taset në pakon e parë, së bashku kanë masë prej 9 gr, taset nga pakoja e dytë së bashku kanë masë prej 8 gr. Cilat tase gjenden në pakon e tretë?

A) 3gr dhe 1gr B) 5gr dhe 2gr C) 6gr dhe 1gr D) 4gr dhe 2gr E) 4gr dhe 3gr


14. Dy pika janë të lidhura në katër mënyra të ndryshme . Cila rrugë është më e shkurtër?




A)



B)



C)




D)

E) të gjitha janë të barabarta

15. Në gjithë një luleje janë shënuar disa numra, si në vizatim. Merita i shkoq ato gjethe me numrat që japin mbetje 2 gjatë pjesëtim me 6. Të përcaktohet shuma e numrave prej gjetheve të shkoqura?

A) 46 B) 66 C) 84 D) 86 E) 114





16. Katër sorra qëndrojnë në një luadh. Emrat e tyre janë Dana, Ana, Lena dhe Zora. Dana gjendet në mes të Anës dhe Lenës. Largësia midis Anës dhe Danës është e barabartë me largësinë midis Lenës dhe Zorës. Dana qëndron në largësi 4m prej Zorës. Sa është largësia midis Anës dhe Zorës ?

A) 5 m B) 6 m C) 7 m D) 8 m E) 9 m


Secila prej detyrave me numër rendorë prej 17 deri 24 vlerësohet me 5 pikë

17. Është e lejueshme lëvizje e çfardoshme dhe rrotacion i çfardoshëm i formave në vizatim, por nuk është e lejueshme ato që të përputhen. Cila formë nuk është e shfrytëzuar në vizatim?

A) B) C) D) E)



18. Jetmiri ndërton shtëpiza prej letre. Në vizatim janë paraqitur shtëpiza me nga një dy dhe tre kate që ndërtoi ai. Sa letra i nevoiten Jetmiri për të ndërtuar shtëpizë prej katër katësh?



1 kat
2 letra


2 kate
7 letra

3 kate
15 letra

A) 23 B) 24 C) 25 D) 26 E) 27

19. Trupi djathtas është përfutur me ngjitjen e 10 kubeve. Pastaj trupi është ngjyrosur tërësisht (duke e përfshirë edhe pjesën e poshtëme). Gjithësej sa faqe prej kubeve janë ngjyrosur?

A) 18 B) 24 C) 30 D) 36 E) 42



20. Irena, Ana, Kate, Olga dhe Elena jetojnë në një shtëpi: dy nga vajzat jetojnë në katin e parë, ndërsa tri të tjerat në katin e dytë. Olga jeton në kat të ndryshëm nga Kate dhe Elena. Ana jeton në kat të ndryshëm nga Irena dhe Kate. Cila jeton në katin e parë ?

- A) Kate dhe Elena B) Irena dhe Elena C) Irena dhe Olga
D) Irena dhe Kate E) Ana dhe Olga

21. Në shprehjen $2002 \square 2003 \square 2004 \square 2005 \square 2006$, në secilin prej katrorëve mund të shënohet shenja $+$ ose $-$. Cili nga rezultatet është i pamundshëm ?

- A) 1998 B) 2001 C) 2002 D) 2004 E) 2006

22. Nëse në një muaj ka 5 të hëna atëherë në atë muaj nuk mund të ketë

- A) 5 të shtuna B) 5 të diela C) 5 të marta
D) 5 të mërkura E) 5 të enjte

23. Në secilën prej 9 fushave të katrorit shënohen numrat 1, 2 ose 3 ashtu që në çdo rend horizontal dhe në çdo kolonë vertikale është shënuar secila prej shifrave 1, 2 dhe 3. Nëse në fushën e epërme të majtë gjendet numri 1, atëherë në sa mënyra mund të plotësohet katrori?

- A) 2 B) 3 C) 4 D) 5 E) 8

1		

24. Lodra fëmimore rrin pezull në tavan dhe është në baraspeshë në të gjitha 5 vendet e shënuara me $\circ$. Forma të njëjta kanë masë të njëjtë. Masa e njërës prej formave peshon 30 gram. Sa do të jetë masa e formës që është shënuar me pikëpyetje ?

- A) 10 B) 20 C) 30
D) 40 E) 50

